



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Shkurt 2021

Nr. 41

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuara në vendimin nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Kryetarit të Bashkisë Z. Sotiraq Filo

Kërkues: Lëvizja Socialiste për Integrim

Ndaj: z. Sotiraq Filo

Baza ligjore: Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi dëgjoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kallëzuesit dhe të kallëzuarit, dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), për shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit më datë 19.01.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 811 ora 11:14, pretendohet se: “Më datë 18.01.2021 Kryetari i Bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo ka

Për mosfillim të procedurës administrative të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj ndaj z.

Sotiraq Filo.

Data: 9 Shkurt 2021

Nr. 41



publikuar në faqen e tij Facebook një veprimtari me karakter publik me mbishkrimin “Ashtu si kudo në Korçë edhe në fshatin Kamenicë kemi bërë shumë punë, e kemi mbajtur shumë premtime. Ndonjëherë i harrojmë por puna është fakt edhe mbetet. Punë të tjera edhe më të mira na presin në vazhdim!”

Sipas denoncuesit: “Ky veprim i tij bie në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror Zgjedhor. Më konkretisht neni 3, pika 1.1 gërma “b” dhe pika 1.3, gërma “ç” e këtij vendimi.”

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Neni 3, paragrafi 2, i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrisë, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Neni 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1,1 shkronja “b” e vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator parashikon se mbështetja dhe promovimi i projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik, **përbëjnë veprimtari të ndaluar për tu promovuar vetëm nëse për të janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë**



transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Në rastin konkret postimi në llogarinë e Kryetarit të Bashkisë Korçë në Facebook nuk e bën veprimtarinë publike. Postimi dhe veprimtaria janë dy ngjarje të dallueshme qartë nga njëra tjetra dhe të zhvendosura në kohë. Nga ana tjetër, Facebook-u apo media të tjera sociale nuk bëjnë pjesë në kategorinë “media” që kërkon paragrafi 1 i nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Dispozita kërkon “pjesëmarrje” të medias, që t’u konsiderojë veprimtarinë publike. Facebook-u nuk ka marrë pjesë në veprimtari sepse Facebook-u nuk është media që “merr pjesë”. Denoncimit i mungon karakteri publik që kërkon nënparagrafi 1.1 i nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Karakteri publik është kushti që ndan lejimin nga ndalimi i veprimtarisë.

Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, shkronja “ç” i vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar se “veprimtari të ndaluara”, janë dhe ato veprimtari që përfshijnë:

“përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”

Në këtë rast, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të trajtoj këtë denoncim për sa kohë që periudha e ndalimit për këtë veprimtari është vetëm “gjatë fushatës zgjedhore”.

Referuar sa më sipër ndalimi lidhet vetëm në rastet kur veprimtaria publike është veprimtari e ndaluar në kuptim të përkufizimeve të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 dhe kjo veprimtari kryhet nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak se kallëzimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative për shkak se kallëzimi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 9 Shkurt 2021

Nr. 41

Për mosfillim të procedurës administrative të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Sotiraq

Filo.